



Planuar / Dorezuar Prilimje/Prodato Received/Delivery	12.05	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	4211/2023		1/2	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.692/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Vjollca Sinani- Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesën me numër A.nr.692/2023 të datës 02.05.2023 e parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/ Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i inicuar sipas ankesës me numër A.nr.692/2023 të datës 02.05.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt emërimit të datës 12.01.2023 në pozitën "Inspektor i Tregut", në Komunën e Lipjanit me datën 02.05.2023 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3977/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se është kategorizuar në nivelin profesional 3 e që sipas pozitës është dashur të jetë profesional 1 sikurse koleget e tij në Komunën e Lipjanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.05.2023 e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Lipjanit, ndërsa kjo e fundit me datën 05.02.2023, përmes emailit ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, dhe ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit është bërë i pamundur, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 02.05.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me A.nr.692, ndërsa ankuesi me datë 05.05.2023, përmes shkresës me numër të protokollit 4064/2023 të datës 05.05.2023, ka deklaruar se e tërheq ankesën që është objekt i shqyrtimit në këshill sepse është shqyrtuar ankesa nga organi i punësimit dhe është rregulluar sipas kërkesës së ankuesit. Kolegji i Këshillit bazuar në këto rrethana, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", andaj në këtë kuptim ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.692/2023, datë 12/05/2023.

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së